



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.911/7 prot.

Datë 08.05.2024

V E N D I M

Nr.463/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr. 8240, Njësia Nr.6, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A me adresë: Lagja “ 18 Tetori ” Lushnje”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

II.2. Me vendimin nr. 246/2024 datë 06.03.2024 KPP ka vendosur:

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.3. Referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit sipas konstatimeve të KPP të shprehura në vendimin nr. 246/2024 datë 06.03.2024.

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datën 21.03.2024 ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.5. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datën 21.03.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “2 AT”	2 105 032 lekë	kualifikuar
2. Albania Distribution Chemicals	3 140 800 lekë	kualifikuar
3. ATLANTIK 3	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

II.6. Me vendimin nr. 311/2024 datë 28.03.2024 KPP ka vendosur:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Në datën 11.04.2024, nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton, se është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.8. Në datën 15.04.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me numër ankimi elektronik A/20244/3969 dhe me nr. 911/2024 prot., datë 16.04.2024 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi konkretisht ankimuesi ka pretenduar se: “[...]

Ne datën në 27 Mars, u zhvillua workshopi në lidhje me prezantimin e manualeve mbi procedurat e ankesave për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë në fushën e prokurimit publik, organizuar nga ju Komisioni i Prokurimit Publik dhe me konsulencën e ekspertëve të Sigma OECD, ne te cilim morem pjese dhe ne si Operator Ekonomik i interesuar. Ne disa nga pyetjet qe u bene ate dite ishte dhe nje pyetje, ku nga juristi juaj u

dha nje pergjigje e qe lidhet me drejt per drejt me ankesen tone. (<https://www.youtube.com/watch?v=FEXTfPf-a3Q>) e gjeni ne min 6:03:36. Ne rastin kur ka ankesa per dokumenta tenderi ose modifikimin e dokumentave te tenderit, qe ne momentin qe paraqitet ankesa pezullohet procedura me afat deri ne momentin kur Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim perfundimtar. Ne rast kur vendimi ka dale mbas afatit te dorëzimit te dokumentave dhe ofertave presupozohet qe me ligj procedura eshte e pezulluar dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund te kishte vazhduar me proceduren e hapjes se ofertave. Ne kete rast e drejta e Operatorit Ekonomik nga e drejta per te paraqitur ankesa per dokumenta tenderi, mund te paraqes ankesa per veprime procedurale. Pra ne cdo rast e drejta per ankim nuk shuhet, dhe eshte e drejte e cila rivendos afat per cdo lloj hapi ose veprime procedurale ne kundërshtim me Ligjin. Atehere Autoriteti Kontraktor nuk ka pritur Vendimin me Nr 311/2024, date 28.03.2024, ku citohet se lejon Autoritetin Kontraktor per lejimin e hapave te metejshem per proceduren ne fjale, por ka hapur ofertat perpara Vendimit te KPP, ne daten 18.03.2024 Bazur ne ate cka juristi juaj citon ne pergjigjen e tij te siper permendur, kerkojme qe kjo procedure prokurimi te anulohet, per shkak se Autoriteti Kontraktor nuk respektoi afatet sipas ligjit. Kerkojme qe kjo procedure prokurimi te anulohet.”

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe u publikua formulari për publikim me ne.911/2 prot., datë 16.04.2024.

II.10. Me datë 19.04.2024 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike informacionin në lidhje me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues e cila u protokollua me tonën me nr. 911/3 prot., datë 22.04.2024, duke arsyetuar si më poshtë: “Në lidhje me ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik, na u vendos në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm: Dokumentet Standarte të Tenderit, procedura me Nr. REF-95992-02-21-2024 “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi, për nevojat e shoqërisë”, Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje sh.a. Për sa më sipër pas ankesës së ardhur me datë 26.02.2024 nga Operatori Ekonomik “Albania Distribution Chemical shpk”, për ndryshime në Dokumentat Standarte të Tenderit është bërë pezullimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës. Më datë 27.02.2024 u ngrit Urdhëri me Nr.32, Nr.441/5 Prot. për pezullimin dhe shqyrtimin e ankesës dhe me date 29.02.2024 Komisioni i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor merr Vendimin e shqyrtimit të ankesës me Nr.441/7 Prot., i cili i është komunikuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe Operatorit Ekonomik në mënyrë elektronike dhe shkresore. Pas kësaj faze, KPP dërgon Vendimin me Nr.642/2024, datë 06.03.2024 ku vendos: -Të pranojë pjesërisht ankesën e Operatorit Ekonomik “Albania Distribution Chemicals” shpk në procedurë e hapur e thjeshtuar me Nr. REF-95992-02-21-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa Tvsh , parashikuar për tu zhvilluar me datë 07.03.2024, nga Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.a. - Autoriteti Kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik . Pas përfundimit të shtojcës me datë 11.03.2024 nga AK, afati i dorëzimit të dokumentave u shty me 8 (tetë) ditë. Dhe pas përfundimit të 8 (tetë) ditëve,

respektivisht me afatin e Vendimit të KPP, me datë 18.03.2024 u bë hapja për vlerësimin e ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Ndër Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë, ka qenë edhe Operatori Ekonomik në fjalë “Albania Distribution Chemicals”, i cili ka marrë pjesë me ofertën e tij. Nëse nuk do të ishte respektuar afati atëherë ai nuk do kishte mundur të ishte pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi. Pra pretendimi se nuk janë respektuar afatet nuk e ka penguar Operatorin të marrë pjesë në këtë procedurë. Ne Workshop-in e organizuar nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe eksperteve të Sigma OCED ne te cilën ishim prezent edhe ne si Autoritet Kontraktor, u citua se: - Per Proçedurat e Prokurimit Publik te nisura para dates 20.03.2024 do te vijojne te realizohen sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi, e momentin e fillimit/nisjes se tyre. Ndersa, Proçedurat e Prokurimit qe do te nisin (me nxjerjen e Urdhrit te Prokurimit) me date 20.03.2024 e ne vijim, do ti nenshtrohen parashikimeve te reja ligjore. Gjithashtu aktet nenligjore te nxjera ne momentin e hyrjes ne fuqi te ligjit Nr.16/2024, te cilat nuk bien ne kundërshtim me kete te fundit, do te zbatohen deri ne nxjerjen e akteve nenligjore ne zbatim te tij. Pra ju rikujtojme se kjo Proçedure Prokurimi eshte hedhur ne SPE me date 21.02.2024, bazuar ne ligjin 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, pra nuk perfshihet ne ndryshimet e reja qe jane bere ne ligjin e prokurimit. Pra mbështetur në pikat e sipërpërmendura, Autoriteti Kontraktor ka pranuar zbatimin e këtij Vendimi dhe mbështetur në Ligjin për prokurimet publike, Neni 75, pika 2, thuhet se: “Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, Autoriteti Kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave dhe nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave Autoriteti ose Enti Kontraktor mund të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për proçedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për proçedurat nën kufirin e lartë monetar. Pra në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje sh.a zgjati afatin me 8 (tetë) ditë për pranimin e ofertave. Mbështetur ne VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik” Neni 103 citohet se “Komisioni i Prokurimit Publik në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës , kur nuk vendos pezullimin , mund ta lejojë autoritetin / entin kontraktor me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin kontraktor ose oferuesit”. Përsa i përket të gjitha fakteve dhe dokumentave të pasqyruara më lart, arrijmë në konkluzionin se veprimet e kryera nga Autoriteti Kontraktor janë kryer të gjitha konform me ligjin. Të ndodhur në këto kushte, në fazën e Njoftimit të Fituesit Paraparak, në rast se KPP gjykon se ky veprim është i pambështetur në dispozitat ligjore , VKM Nr..285, date 19.05.2021, Neni 103, pika 2 përpara lidhjes së Kontrates, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të vendos në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të proçedurës dhe në çdo rast do të zbatojmë vendimin e dhënë.

VENDOSI:

Bazuar në shqyrtimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, për ankesën e Operatorit Ekonomik “Albania Distribution Chemicals shpk”, vendosi pranimin e shqyrtimit të ankesës. Në zbatim të VKM -së Nr.285, date 19.05.2021 i ndryshuar, neni 102, kjo shkresë do të dërgohet OE në rrugë elektronike dhe shkresore që është përcaktuar në formularin e ankesës. Ky formular do të dërgohet gjithashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik .”

II.11. Me datë 29.04.2024 ankimuesi ka dërguar në KPP përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) njoftimin se nuk ka marrë përgjigje nga autoriteti kontraktor në lidhje me trajtimin e ankesës dhe duke i kërkuar KPP-së që të detyrojë autoritetin kontraktor për të dhene përgjigje ose të vihet në dizpozicion nje kopje e vendimit te autoritetit kontraktor.

II.12. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente të paraqitura nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar .

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit të paraqitur në ankesën me numër ankimi elektronik A/20244/3969 dhe me nr. 911/2024 prot., datë 16.04.2024 se:

“[....] Ne daten në 27 Mars, u zhvillua workshopi në lidhje me prezantimin e manualeve mbi procedurat e ankesave për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë në fushën e prokurimit publik, organizuar nga ju Komisioni i Prokurimit Publik dhe me konsulencën e ekspertëve të Sigma OECD, ne te cilim morem pjese dhe ne si Operator Ekonomik i interesuar. Ne disa nga pyetjet qe u bene ate dite ishte dhe nje pyetje, ku nga juristi juaj u dha nje pergjigje e qe lidhet me drejt per drejt me ankesen tone. (<https://www.youtube.com/watch?v=FEXTfPf-a3Q>) e gjeni ne min 6:03:36. Ne rastin kur ka ankese per dokumenta tenderi ose modifikimin e dokumentave te tenderit, qe ne momentin qe paraqitet ankesa pezullohet procedura me afat deri ne momentin kur Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim perfundimtar. Ne rast kur vendimi ka dale mbas afatit te dorezimit te dokumentave dhe ofertave presupozohet qe me ligj procedura eshte e pezulluar dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund te kishte vazhduar me proceduren e hapjes se ofertave. Ne kete rast e drejta e Operatorit Ekonomik nga e drejta per te paraqitur ankese per dokumenta tenderi, mund te paraqes ankese per veprime proceduriale. Pra ne cdo rast e drejta per ankim nuk shuhet, dhe eshte e drejte e cila rivendos afat per cdo lloj hapi ose veprime proceduriale ne kundershtrim me Ligjin. Atehere Autoriteti Kontraktor nuk ka pritur Vendimin me Nr 311/2024, date 28.03.2024, ku citohet se lejon Autoritetin Kontraktor per lejimin e hapave te metejshem per proceduren ne fjale, por ka hapur ofertat perpara Vendimit te KPP, ne daten 18.03.2024 Bazur ne ate cka juristi juaj citon ne pergjigjen e tij te siper permendur, kerkojme qe kjo procedure prokurimi te anulohet, per shkak se Autoriteti Kontraktor nuk respektoi afatet sipas ligjit. Kerkojme qe kjo procedure prokurimi te anulohet.” KPP vëren se,

III.1.1. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 21.03.2024 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datën 21.03.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “2 AT”	2 105 032 lekë	kualifikuar
2. Albania Distribution Chemicals	3 140 800 lekë	kualifikuar
3. ATLANTIK 3	pa ofertë ekonomike	skualifikuar

III.1.3. Me vendimin nr. 246/2024 datë 06.03.2024 KPP ka vendosur:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
- 5. I Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.4. Referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit sipas konstatimeve të KPP të shprehura në vendimin nr. 246/2024 datë 06.03.2024.

III.1.5. Me vendimin nr. 311/2024 datë 28.03.2024 KPP ka vendosur:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024 me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 07.03.2024, nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.6. Në nenin 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimi publik” parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;
 - b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;
 - d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.
5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”

III.1.7. Në nenin 100 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se :
“1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.8. Në rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot. Datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit” parashikohet se: “2. Me marrjen e vendimit të KPP mbi themelin e çështjes, autoriteti kontraktor, duhet të hartojë shtojcën përkatëse, të cilën duhet ta publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (në vijim "SPE"). Autoriteti Kontraktor duhet të reflektojë në shtojcat e hartuara në zbatim të vendimit të dhënë, të gjitha ndryshimet që përmban vendimi i KPP, dhe të vërë në dijeni KPP mbi zbatimin e vendimit.

3. KPP, me marrjen e informacionit të autoritetit kontraktor dhe në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, do të vijojë me nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm për heqjen ose jo të pezullimit të procedurës së prokurimit.

Kujdes!AK nuk duhet ta nxjerrë një procedure nga statusi i pezulluar dhe nuk duhet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës, pa nxjerrë KPP një vendim për heqjen e pezullimit.

4. Në rast se KPP konstaton se:

a) autoritetet kontraktore kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP me vendim të arsyetuar vendos heqjen e pezullimit. Pasi vihet në dijeni të këtij vendimi, autoriteti kontraktor duhet të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 2/1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe më pas të nxjerrë procedurën nga pezullimi.

b) autoritetet kontraktor nuk kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP vendos për lënien në fuqi të masës së pezullimit. Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë menjëherë

vendimin, si dhe të publikojë shtojcën mbi ndryshimin e dokumentave të tenderit në SPE dhe të njoftojë KPP.

Në çdo rast, me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomik bazuar në parimin e transparencës, si dhe duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin e heqjes së pezullimit, autoritetet kontraktore rekomandohen të shtyjnë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 21, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, vetëm pas marrjes dijani të vendimit për heqjen e pezullimit nga ana e KPP-së.”

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe veprimet e autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke hapur dhe vlerësuar ofertat përkatësisht me datë 21.03.2024 pa nxjerrë KPP një vendim që lejon autoritetin kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës, pasi ky vendim mban datën 28.03.2024 pra pasi autoriteti ka hapur dhe vlerësuar ofertat. Përmes këtij veprimi, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot. Datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit” në të cilin parashikohet se: “2. Me marrjen dijani të vendimit të KPP mbi themelin e çeshtjes, autoriteti kontraktor, duhet të hartojë shtojcën përkatëse, të cilën duhet ta publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (në vijim “SPE”). Autoriteti Kontraktor duhet të reflektojë në shtojcat e hartuara në zbatim të vendimit të dhënë, të gjitha ndryshimet që përmban vendimi i KPP, dhe të vërë në dijani KPP mbi zbatimin e vendimit.

3. KPP, me marrjen e informacionit të autoritetit kontraktor dhe në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, do të vijojë me nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm për heqjen ose jo të pezullimit të procedurës së prokurimit.

Kujdes!AK nuk duhet ta nxjerrë një procedure nga statusi i pezulluar dhe nuk duhet të vijojë me hapat e tjerë të procedurës, pa nxjerrë KPP një vendim për heqjen e pezullimit.

4. Në rast se KPP konstaton se:

a) autoritetet kontraktore kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP me vendim të arsyetuar vendos heqjen e pezullimit. Pasi vihet në dijani të këtij vendimi, autoriteti kontraktor duhet të shtyjë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 2/1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe më pas të nxjerrë procedurën nga pezullimi.

b) autoritetet kontraktor nuk kanë zbatuar me korrektesë vendimin, KPP vendos për lënien në fuqi të masës së pezullimit. Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë menjëherë vendimin, si dhe të publikojë shtojcën mbi ndryshimin e dokumentave të tenderit në SPE dhe të njoftojë KPP.

Në çdo rast, me qëllim trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomik bazuar në parimin e transparencës, si dhe duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin e heqjes së pezullimit, autoritetet kontraktore rekomandohen të shtyjnë afatin për dorëzimin e ofertave në përputhje me nenin 42, pika 21, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, vetëm pas marrjes dijani të vendimit për heqjen e pezullimit nga ana e KPP-së.”

Gjithashtu në nenin 100 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se :

“1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

Sa më sipër duke qenë se vendimi i KPP konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin që KPP lejon autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk duhej të vazhdonte me tej procedurën në rastin konkret me heqjen nga pezullimi në sistem pa një vendim të KPP-së.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke e hequr nga pezullimi atë pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj. Në këtë kuadër duke qenë se, autoriteti kontraktor në aspektin procedural ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot., datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 *“Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit”* KPP gjykon, se ky rast duhet t’i referohet Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e hetimit administrativ bazuar në nenin 23 të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*.

III.2. Ndërsa lidhur me pretendimet e ankimuesit për anulimin e procedurës së prokurimit me arsyetimin se *“[...]Autoriteti kontraktor nuk ka pritur Vendimin me Nr.311/2024, date 28.03.2024 ku citohet se lejon autoritetin kontraktor për lejimin e hapave të mëtejshëm për procedure në fjale por ka hapur ofertat përpara vendimit të KPP në datën 18.03.2024.... Kërkojmë që kjo procedure prokurimi të anulohet për shkak se autoriteti kontraktor nuk respektoi afatet sipas ligjit. Kërkojmë që kjo procedure prokurimi të anulohet.”* KPP gjykon se nuk ndodhemi para asnjërës prej arsyeve që parashikon neni 98 i *lex specialis* për anulimin e procedurës së prokurimit dhe ku akoma më tej referuar sistemit të prokurimit elektronik dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit, është vlerësuar oferta e tij dhe nga ku rezulton i kualifikuar. Pra në asnjë moment nuk është cënuar interesi i tij ligjshëm nga veprimet e autoritetit kontraktor për të paraqitur ofertën e tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Komisioni gjykon se nëse ankimuesi do të kishte pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit dhe zbatimin e vendimi të KPP ka patur në dispozicion momentin procedural të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 e *lex specialis*, në rastin konkret brenda 7 ditëve nga publikimi i modifikimit të kërkesave për kualifikim të cilat janë pjesë integrale e dokumenteve standarde

të tenderit. Në këtë rast KPP gjykon se autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës duke e hequr nga pezullimi atë pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj por përmes këtyre veprimeve nuk janë çenuar interesat e ligjshëm të operatorit ekonomik për sa kohë që: *se pari*, autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit të KPP ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit dhe ku mbi përmbajtjen e saj ankimesi nuk ka shfaqur pretendime pasi nëse do të kishte pretendime duhet të ushtronte të drejtën e ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 të *lex specialis* dhe ku vetë KPP përmes vendimit nr. 311/2024 datë 28.03.2024 pas verifikimit të përmbajtjes së dokumenteve të tenderit të modifikuar përmes shtojcës ka lejuar KPP për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës; *së dyti*, ankimesit nuk i është mohuar e drejta për të paraqitur ofertën e tij në procedurën e prokurimit dhe përmes saj të të konkuronte për të fituar kontratën publike. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se hapat procedurale të ndjekur nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-prokurimi nuk cenojnë në thelb garancitë procedurale të operatorit ekonomik ankimes por njëherazi as parimin e sigurisë juridike. Në jurisiprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Sa më sipër KPP konstaton se jemi para veprimeve procedurale të gabuara duke vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit pa pritur një vendim të KPP që lejon autoritetin kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës por nga këto veprime sic është argumentuar më sipër nuk janë çenuar interesat e ligjshëm të operatorit ekonomik ankimes dhe nuk ndodhemi para rasis për anulimin e procedurës së prokurimit sikurse pretendon ankimesi.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Nenit 4 të Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-95992-02-21-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”, me fond limit 3,343,640.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje SH.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ sipas konstatimeve të mësipërme.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

